



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Korçë më 07.11.2025

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë z.Sotiraq Filo

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotiraq Filo, se ditën e **martë**, datë **11 nëntor 2025, ora 13⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja jashtë rradhe e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë nr.11717prot. datë 07.11.2025 dhe në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 me rend dite si më poshtë:

- 1- "PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS".
- 2- "PËR DHËNIË TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCAVE NË FSHATRAT LAVDAR, TURAN, VOSKOP DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR".

(**Komisioni i Rregullores, Çështjeve ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë**)
z.Erjon Nexhipi, znj.Edlira Mire, z.Erjon kurti, z.Kristiano Kocibelli, znj. Mirela Qeleshi .

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e hënë , datë 10.11.2025, ora 11⁰⁰ .

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

NR. _____ PROT.

DATË _____ / _____ / 2025

RELACION

PËR

**‘DHËNIE TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCAVE NË FSHATRAT LAVDAR,
TURAN, VOSKOP DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT
SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR’**

Nga shoqata Gjysmëhëna e Kuqe është propozuar ndërtimi i tre objekteve Ambulanca të Tipit A-2, në fshatrat Lavdar, Turan dhe Voskop. Ndërtimi i këtyre objekteve do të bëhet në pronat e Bashkisë Korçë dhe në përfundim të projektit i cili do të miratohet me lejë ndërtimi, do ti dhurohen Bashkisë Korçë.

Shoqata do të ndërtojë 3 objektet mbi pasuritë, pronë e Bashkisë Korçë dhe konkretisht:

- 1- Në fshatin Lavdar Njësia Administrative Voskopojë, mbi pasurinë 1280 ZK. 2390;
- 2- Në fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë, mbi pasurinë 36/12 ZK 36/60
- 3- Në fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë, mbi pasurinë 341/2 ZK 3818

Të drejtat dhe detyrimet që do lindin nga ky bashkëpunim janë të materializuar në marrëveshjen bashkangjitur këtij materiali.

Sa më lart dhe bazuar në bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) *“njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj”* dhe c) *“e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës”* të ligjit 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* i ndryshuar, ligjin 8744 datë 22.02.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësive të qeverisjes vendore”*,

Kodi Civil i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të japë pëlqimin dhe të vendosë në dispozicion të shoqatës Gjasmëhëna e Kuqe pasuritë e sipërcituara me qëllim ndërtimin mbi këto pasuri të objekteve, Ambulanca të Tipit A-2 dhe miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit, sipas materialit bashkangjitur.

Drejtore e Përgjithshme:

A. Qeramixhi (Dishnica)

Drejtore I DPPTMKI

Ndriçim Hoxha

KRYETAR I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr._____, datë ____/____/2025

PËR

**‘DHËNIE TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCAVE NË FSHATRAT LAVDAR,
TURAN, VOSKOP DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT
SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërma a) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësi të vetëqeverisjes vendore”, dhe Kodin Civil

VENDOSI:

1. Të vendosë/ mos vendosë në dispozicion të Shoqatës Gjysmëhëna e Kuqe, pasuritë:

- Nr. 1280 ZK. 2390 ndodhur në fshatin Lavdar Njësia Administrative Voskopojë ;
- Nr. 36/12 ZK 36/60 ndodhur në fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë dhe
- Nr. 341/2 ZK 3818 ndodhur në fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë me qëllim ndërtimin mbi këto pasuri të objekteve, Ambulanca të Tipit A-2.

2. Të miratojë/mosmiratojë marrëveshjen e bashkëpunimit sipas tekstit bashkëngjitur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR NDËRTIMIN DHE PAJISJEN E OBJEKTEVE
“NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDTETSORE TIPI A-2”,
BASHKIA KORÇË.

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis:

1. SHOQATA “GJYSMËHËNA E KUQE” E E.B.A. –ZYRA NË SHQIPËRI

DHE

2-BASHKIA KORÇË.

3-DREJTORISË RAJONALE TË SHËNDETIT PUBLIK KORÇË.

PALËT NËNSHKRUESE TË KËSAJ AKT-MARRËVESHJE PËRFAQËSOHEN NGA:

1- Shoqata “Gjysmëhëna e Kuqe “ e Emirateve të Bashkuara Arabe –Zyra në Shqipëri, Kordinatori i saj, z. Behar Bejko, me seli në Rrugën “Sulejman Delvina “ Qendra “Zayed” Tiranë,

në vijim Donatori/ respektivisht DHURUESI I
OBJEKTIT

2- Bashkia Korçë e përfaqësuar nga kryetari i saj, z. Sotiraq Filo

PRANUESI I DHURIMIT

3- Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë, Përfaqësuar nga Drejtori i saj z

NENI 1
OBJEKTI

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive përkatëse teknike, ligjore dhe financiare, për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin dhe pajisjen e objektet “Ndërtimi ambulancave Tip.A-2”, në:

1-Fshati Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë

2-Fshati Turan Njësia Administrative Drenovë

3-Fshati Voskop Njësia Administrative Voskopojë

NENI 2 BAZA LIGJORE

1-Ligji Nr.7850 datë 29/07/1994 Kodi civil i Republikës së Shqipërisë, pjesa V-kontratat, Titulli“Kontratat në përgjithësi“ Nenet 659,660,662,663,664 e vijues, Kreu i III, titulli“Kontratat e dhurimit“ neni 761 e vijues.

- Ligji Nr.8788 datë 07/05/2001 “Për organizatat jo fitimprurëse“
- Ligji Nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“ I ndryshuar.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMAT E PALËVE

1. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DONATORIT JANË:

- 1.1 Të siguroj, realizoj dhe disbursoj donacionet për Ndërtimin e ambulancave Tip.A-2” objekt i kësaj Marrëveshje-Bashkia Korçë, sipas vlerës dhe preventivit përkatës bashkamgjitur.
- 1.2 **Donatori depoziton në llogarinë e tij shumën 1 106.837(Njëmilion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë) Lekë për ndërtimin, dhe shumën 520 000 (Pesëqind e njëzetë mijë) lekë të reja, për pajisjen e plotë me pajisjet mjekësore, kjo shumë për sejcilën Ambulancë Tip A2 vendodhja e listuar në Objektin e kësaj Marrëveshje.**
- 1.3 Të lidh kontratën e sipërmarrjes me kompani të specializuara në fushat përkatëse (ndërtim dhe furnizim me pajisje mjekësore).
- 1.4 Të ndjek me rigorozitet dhe efektivitet, zbatimin e kontratës së lidhur me subjektin, e përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.
- 1.5 Të marrë masat e nevojshme për përfundimin e objektit në afat, me cilësi dhe sipas e standarteve bashkëkohore.
- 1.6 Të mbikqyrë punimet dhe hartojë dokumentacionin identifikues sipas fazave dhe llojit të ndërtimit, supervizojë punimet dhe ti marrë në dorëzim, sa më sipër trajtohen dhe përcaktohen me hollësi në kontratën e sipërmarrjes.
- 1.7 Pas përfundimit, t’i dhurojë me kontratë ligjore, objektin përfituesit të donacionit respektivisht pranuesit të dhurimit Bashkisë Korçë.
- 1.8 Pas përfundimit, t’i dhurojë me kontratë ligjore, pajisjet mjekësore përfituesit të donacionit respektivisht pranuesit të dhurimit Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit (Bashkia Korçë)

- 2.1 Të pranoj donacionin objektet e ndërtuara mbi truallin e Bashkisë Korçë, Ambulanca Tip.A-2” në:
 - 1-Fshatin Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë
 - 2-Fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë
 - 3-Fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë
- 2.2 Të bashkëpunojë për hartimin e miratimin e dokumentacionit teknik e ligjor.
- 2.3 Të ndihmojë për mbarëvajtjen e punimeve pa pengesa.
- 2.4 Të sigurojë e miratojë dokumentat ligjore të truallit mbi të cilin do të ndërtohen ambulancat dhe të pajisë me lejë për ndërtimin e ambulancave Tip.A-2” në:
 - 1-Fshatin Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë

2-Fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë

3-Fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë

2.5 Të siguroj për objektin lidhjen e linjës elektrike , të ujësjellësit dhe kanalizimet e ujrave të zeza

2.7. Merr përsipër rregjistrimin e pronës Agjencinë Shtetërore të Kadastrës duke përfituar edhe dokumentin përkatës.

3. Të drejtat dhe detyrimet e DRSHP KORÇË.

3.1.Të pranojë pajisjet mjeksore nga dhuruesi.

3.2. Të marrë në dorëzim dhe të përdorë objektin sipas destinacionit.

4- TË PËRBASHKËTA

4/1- Të bashkërendojnë veprimtarinë për përgatitjen e dokumentave (dosjes) për dhurimin dhe pranimin e Dhurimit.

4/2 Në bashkëpunim, të organizojnë ceremoninë e inagurimit të objektit ku nënshkruhet edhe kontrata e Dhurimit të tij.

NENI 5

LIGJI I ZBATUESHËM

Për çështjet që nuk janë parashikuar ose që mundet të lindin gjatë zbatimit të kontratave, zbatohen dispozitave përkatëse të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

NENI 6

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, hartohet me vullnetin e lirë të palëve, në 3 (tre) ekzemplar të njëjtë e të barazvlefshëm në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese të saj dhe Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

DHURUESI

SHOQATA “GJYSMËHËNA E KUQE” E EBA- RSH

KORDINATORI

PËRFITUESI I DHURIMIT

BASHKIA KORÇË

KRYETARI

SOTIRAQ FILO

PALA E INTERESUAR

DRSHP KORÇË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR NDËRTIMIN DHE PAJISJEN E OBJEKTEVE
“NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDTETSORE TIPI A-2”,
BASHKIA KORÇË.

Lidhot kjo marrëveshje bashkëpunimi midis:

1. SHOQATA “GJYSMËHËNA E KUQE” E E.B.A. –ZYRA NË SHQIPËRI

DHE

2-BASHKIA KORÇË.

3-DREJTORISË RAJONALE TË SHËNDETIT PUBLIK KORÇË.

PALËT NËNSHKRUESE TË KËSAJ AKT-MARRËVESHJE PËRFAQËSOHEN NGA:

1- Shoqata “Gjysmëhëna e Kuqe “ e Emirateve të Bashkuara Arabe –Zyra në Shqipëri, Kordinatori i saj, z. Behar Bejko, me seli në Rrugën “Sulejman Delvina “ Qendra “Zayed” Tiranë,
në vijim Donatori/ respektivisht DHURUESI I OBJEKTIT

2- Bashkia Korçë e përfaqësuar nga kryetari i saj, z. Sotiraq Filo

PRANUESI I DHURIMIT

3- Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë, Përfaqësuar nga Drejtori i saj z. _____

NENI 1
OBJEKTI

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësiive përkatëse teknike, ligjore dhe financiare, për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin dhe pajisjen e objektet “**Ndërtimi ambulancave Tip.A-2**”, në:

- 1-Fshati Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë
- 2-Fshati Turan Njësia Administrative Drenovë
- 3-Fshati Voskop Njësia Administrative Voskopojë

NENI 2
BAZA LIGJORE

1-Ligji Nr.7850 datë 29/07/1994 Kodi civil i Republikës së Shqipërisë, pjesa V-kontratrat, Titulli“Kontratrat në përgjithësi“ Nenet 659,660,662,663,664 e vijues, Kreu i III, titulli“Kontratrat e dhurimit“ neni 761 e vijues.

- Ligji Nr.8788 datë 07/05/2001 “Për organizatat jo fitimprurëse“
- Ligji Nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“ I ndryshuar.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMAT E PALËVE

1. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DONATORIT JANË:

- 1.1 Të siguroj, realizoj dhe disbursoj donacionet për Ndërtimin e ambulancava Tip.A-2” objekt i kësaj Marrëveshje-Bashkia Korçë, sipas vlerës dhe preventivit përkatës bashkamgjitur.
- 1.2 Donatori depoziton në llogarinë e tij shumën 1 106.837(Njëmilion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë) Lekë për ndërtimin, dhe shumën 520 000 (Pesëqind e njëzetë mijë) lekë të reja, për pajisjen e plotë me pajisjet mjekësore, kjo shumë për sejcilën Ambulancë Tip A2 vendodhja e listuar në Objektivin e kësaj Marrëveshje.
- 1.3 Të lidh kontratën e sipërmarrjes me kompani të specializuara në fushat përkatëse (ndërtim dhe furnizim me pajisje mjekësore).
- 1.4 Të ndjek me rigorozitet dhe efektivitet, zbatimin e kontratës së lidhur me subjektin, e përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.
- 1.5 Të marrë masat e nevojshme për përfundimin e objektit në afat, me cilësi dhe sipas e standarteve bashkëkohore.
- 1.6 Të mbikqyrë punimet dhe hartojë dokumentacionin identifikues sipas fazave dhe llojit të ndërtimit, supervizojë punimet dhe ti marrë në dorëzim, sa më sipër trajtohen dhe përcaktohen me hollësi në kontratën e sipërmarrjes.
- 1.7 Pas përfundimit, t’i dhurojë me kontratë ligjore, objektin përfituesit të donacionit respektivisht pranuesit të dhurimit Bashkisë Korçë.
- 1.8 Pas përfundimit, t’i dhurojë me kontratë ligjore, pajisjet mjekësore përfituesit të donacionit respektivisht pranuesit të dhurimit Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit (Bashkia Korçë)

- 2.1 Të pranoj donacionin objektet e ndërtuara mbi truallin e Bashkisë Korçë, Ambulanca Tip.A-2” në:
 - 1-Fshatin Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë
 - 2-Fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë
 - 3-Fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë
- 2.2 Të bashkëpunojë për hartimin e miratimin e dokumentacionit teknik e ligjor.
- 2.3 Të ndihmojë për mbarëvajtjen e punimeve pa pengesa.
- 2.4 Të sigurojë e miratojë dokumentat ligjore të truallit mbi të cilin do të ndërtohen ambulancat dhe të pajisë me lejë për ndërtimin e ambulancave Tip.A-2” në:
 - 1-Fshatin Lavdar Njësia Adinistrative Voskopojë
 - 2-Fshatin Turan Njësia Administrative Drenovë
 - 3-Fshatin Voskop Njësia Administrative Voskopojë
- 2.5 Të siguroj për objektin lidhjen e linjës elektrike , të ujësjellësit dhe kanalizimet e ujrave të zeza
- 2.7. Merr përsipër rregjistrimin e pronës Agjencinë Shtetërore të Kadastrës duke përfituar edhe dokumentin përkatës.

3. Të drejtat dhe detyrimet e DRSHP KORÇË.

- 3.1.Të pranojë pajisjet mjekësore nga dhuruesi.
- 3.2. Të marrë në dorëzim dhe të përdorë objektin sipas destinacionit.

4- TË PËRBASHKËTA

- 4/1- Të bashkërendojnë veprimtarinë për përgatitjen e dokumentave (dosjes) për dhurimin dhe pranimin e Dhurimit.
- 4/2 Në bashkëpunim, të organizojnë ceremoninë e inagurimit të objektit ku nënshkruhet edhe kontrata e Dhurimit të tij.

NENI 5
LIGJI I ZBATUESHËM

Për çështjet që nuk janë parashikuar ose që mundet të lindin gjatë zbatimit të kontratave, zbatohen dispozitave përkatëse të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

NENI 6

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, hartohet me vullnetin e lirë të palëve, në 3 (tre) ekzemplar të njëjtë e të barazvlefshëm në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese të saj dhe Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

DHURUESI

SHOQATA “GJYSMËHËNA E KUQE” E EBA- RSH

KORDINATORI

PËRFITUESI I DHURIMIT

BASHKIA KORÇË

KRYETARI

SOTIRAQ FILO

PALA E INTERESUAR

DRSHP KORÇË

PLANI I VENDOSJES SË RRUGËVE

OBJEKTI: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

VENDNDODHJA: FSHATI TURAN.NJ.ADM DRENOVE

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
SOTIRAQ FILO

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

EMËRTIMI I PUNIMEVE: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

NENKATEGORIA : A.BANIM
TIPOLOGJIA E PËRDORIMIT TË TOKËS : ZONE BANIMI
LLOJI I STRUKTURËS :
KODI I PËRDORIMIT SIPAS PLANIT: DR/UB17
ADRESA : FSHATI TURAN.NJ.ADM DRENOVE


TREGUESIT E PËRDORIMIT TË PROPOZUAR:


SIPËRFAQE E TRUALLIT QË ZHVILLOHET	Ekzistuese
SIPERFAQE E ZËNË NGA RRUGËT	Ekzistuese
LATRËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS	Ekzistuese
SIPËRFAQE TOTALE E NDËRTIMIT	24 m ²
NUMRI I KATEVE NATYRALE MBI TOKË	1
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA AUTOMJETET	Ekzistuese
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA KËMBËSORËT	Ekzistuese



SKEMA E VENDODHJES SË ZHVILLIMIT

POZICIONI KADASTRAL I ZONAVE



	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	DREJTORI I DPPTMKI	NDRIÇIM HOXHA
	BASHKIA KORÇË		
Objekti: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA Emërtimi: PLANVENDOSJA		PËRPUNOI :	ING. GJEODET. MELSEN FIRANJ
	2025		

PLANI I VENDOSJES SË RRUGËVE

OBJEKTI: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

VENDNDODHJA: FSHATI VOSKOP.NJ.ADM VOSKOP

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
SOTIRAQ FILO

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

EMËRTIMI I PUNIMEVE: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

NENKATEGORIA : A.BANIM
TIPOLOGJIA E PËRDORIMIT TË TOKËS : ZONE BANIMI
LLOJI I STRUKTURËS :
KODI I PËRDORIMIT SIPAS PLANIT: VO/UB3
ADRESA : FSHATI VOSKOP.NJ.ADM VOSKOP

TREGUESIT E PËRDORIMIT TË PROPOZUAR:

SIPËRFAQE E TRUALLIT QË ZHVILLOHET	Ekzistuese
SIPERFAQE E ZËNË NGA RRUGËT	Ekzistuese
LATRTËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS	Ekzistuese
SIPËRFAQE TOTALE E NDËRTIMIT	24 m ²
NUMRI I KATEVE NATYRALE MBI TOKË	1
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA AUTOMJETET	Ekzistuese
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA KËMBËSORËT	Ekzistuese



SKEMA E VENDODHJES SË ZHVILLIMIT

POZICIONI KADASTRAL I ZONAVE



	REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KORÇË	DREJTORI I DPPTMKI	NDRIÇIM HOXHA
	Objekti: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA Emërtimi: PLANVENDOSJA	PËRPUNOI :	ING. GJEODET. MELSEN FIRANJ
2025			

PLANI I VENDOSJES SË RRUGËVE

OBJEKTI: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

VENDNDODHJA: FSHATI LAVDAR.NJ.ADM VOSKOPOJE

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
SOTIRAQ FILO

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

EMËRTIMI I PUNIMEVE: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA

NENKATEGORIA : A.BANIM
TIPOLOGJIA E PËRDORIMIT TË TOKËS : ZONE BANIMI
LLOJI I STRUKTURËS :
KODI I PËRDORIMIT SIPAS PLANIT: VS/B27
ADRESA : FSHATI LAVDAR.NJ.ADM VOSKOPOJE


TREGUESIT E PËRDORIMIT TË PROPOZUAR:

SIPËRFAQE E TRUALLIT QË ZHVILLOHET	Ekzistuese
SIPERFAQE E ZËNË NGA RRUGËT	Ekzistuese
LATRËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS	Ekzistuese
SIPËRFAQE TOTALE E NDËRTIMIT	24 m2
NUMRI I KATEVE NATYRALE MBI TOKË	1
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA AUTOMJETET	Ekzistuese
SIPËRFAQE E SHFRYTËZUAR NGA KËMBËSORËT	Ekzistuese



SKEMA E VENDODHJES SË ZHVILLIMIT

POZICIONI KADASTRAL I ZONAVE



	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	DREJTORI I DPPTMKI	NDRIÇIM HOXHA
	BASHKIA KORÇË		
Objekti: NDËRTIMI I QËNDRAVE SHËNDETËSOR NË FSHATRA Emërtimi: PLANVENDOSJA		PËRPUNOI :	ING. GJEODET. MELSEN FIRANJ
	2025		